



Konventa
e Këshillit
të Evropës për
Masat kundër
**Trafikimit
të Qenieve
Njerëzore**




Mekanizmi
i monitorimit

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE



CILAT JANË QËLLIMET E KONVENTËS?

— Konventa e Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, e cila ka hyrë në fuqi më 1 shkurt 2008, ka si qëllim të parandalojë trafikimin e qenieve njerëzore, të mbrojë viktimat dhe të ndjekë penalisht trafikantët. Konventa përfshin të gjitha format e trafikimit (qoftë kombëtar ose përtej kufijve kombëtarë, të lidhur me krimin e organizuar ose jo) dhe mbulon të gjithë viktimat e trafikimit (gratë, burrat dhe fëmijët), si dhe të gjitha format e shfrytëzimit. Konventa përfshin po ashtu masa për nxitjen e partneriteteve me shoqërinë civile dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

— Vlera më thelbësore e Konventës është përqendrimi i saj tek të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e viktimave. Konventa e përkufizon trafikimin si një akt i cili është shkelje e të drejtave të njeriut dhe shkelje e dinjitetit dhe e integritetit të qenieve njerëzore. Kjo do të thotë që autoritetet kombëtare janë përgjegjëse në rast se ata nuk marrin masa për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore, për të mbrojtur viktimat dhe për të hetuar me efektivitet rastet e trafikimit.

— Trafikimi i qenieve njerëzore është fenomen mbarëbotëror, dhe si i tillë nuk njeh kufij. Për këtë arsye Konventa është e vlefshme dhe e hapur për të gjitha vendet në botë.



SI MONITOROHET ZBATIMI I KONVENTËS?

— Konventa parashikon krijimin e një mekanizmi të pavarur monitorimi për të vlerësuar se sa mirë janë vënë në jetë dispozitat e saj. Ky mekanizëm monitorimi, i cili konsiderohet si një ndër pikat kryesore dhe më të forta të Konventës, përbëhet nga dy shtylla: Grupi i Ekspertëve kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA) dhe Komiteti i Palëve.

Çfarë është GRETA?

— Grupi i Ekspertëve për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, GRETA, është përgjegjës për vlerësimin e zbatimit të Konventës nga shtetet që e kanë ratifikuar atë. GRETA përbëhet nga 15 ekspertë të pavarur dhe të paanshëm nga shtetet nënshkruese. Ekspertët vijnë nga profesione të ndryshme (profesionistë ligjorë, zyrtarë të zbatimit të ligjit, psikologë, doktorë, përfaqësues të shoqërisë civile, etj.) dhe përzgjidhen bazuar në eksperiencën e tyre profesionale në fushat e mbuluara nga Konventa. Mandati i anëtarëve të GRETA-s është katër vjet, me të drejtë përtëritje vetëm një herë.

Si e realizon GRETA punën e saj monitoruese?

■ Aktivitetet monitoruese të GRETA-s janë ndarë në dy nivele. Në fillim të secilit nivel, GRETA përcakton dispozitat e Konventës që do të jenë objekt monitorimi dhe përcakton mënyrën më të përshtatshme për të kryer vlerësimin.

■ Për realizimin e punës së saj monitoruese, GRETA përdor një sërë metodash për mbledhjen e informacionit. Si hap i parë, GRETA u dërgon një pyetësor autoriteteve të vendit që është objekt vlerësimi. Informacioni i ofruar në përgjigje analizohet nga GRETA dhe, nëse është e nevojshme, GRETA kërkon informacion shtesë për të qartësuar ose për të plotësuar më tej përgjigjen.

■ Përveç dërgimit të pyetësorit, GRETA kryen një vizitë në vendin objekt vlerësimi. Vizita të kësaj natyre lejojnë diskutime të thëlluara me zyrtarët qeveritarë, oficerët e policisë, prokurorët, parlamentarët dhe aktorët e tjerë përkatës.

■ Vizitat e vlerësimit përbëjnë po ashtu një mundësi për GRETA-n për të vizituar ambientet ku ju ofrohet ndihme viktimave të trafikimit. Në këtë mënyrë GRETA mund të kërkojë të vizitojë qendrat e krizës ose të strehimit të viktimave të trafikimit të menaxhuara nga organet publike ose nga OJQ-të, qendrat për emigrantët e parregullt ose azilkërkuesit, pikat kufitare ose spitalet. Këto vizita bëjnë të mundur kontrollin e efektivitetit të masave të marra për të zbatuar Konventën.





ROLI I SHOQËRISË CIVILE

— Një burim i rëndësishëm informacioni për GRETA-n është shoqëria civile. Gjatë vizitave të saj të vlerësimit, GRETA organizon takime me përfaqësues të organizatave jo-qeveritare (OJQ) dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë civile (për shembull sindikatat, shoqatat ligjore, përfaqësues të botës akademike) të përfshirë në masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore. GRETA mund të vendosë t'ia dërgojë pyetësorin e saj, ose çdo kërkesë tjetër, për informim OJQ-ve dhe anëtarëve të tjerë të shoqërisë civile, të cilët kanë burime të besueshme informacionin dhe që janë në gjendje të verifikojnë vërtetësinë e këtij informacioni.



RAPORTET E GRETA-S

— Raportet e vlerësimit të GRETA-s për vendin objekt vlerësimi përmbajnë një analizë të situatës së këtij vendi lidhur me masat për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore si dhe sugjerime për të forcuar zbatimin e Konventës. Raportet hartohen në frymë bashkëpunuese dhe kanë për qëllim t'u vijjnë në ndihmë shteteve në përpjekjet e tyre.

— GRETA i shqyrton projekt raportet e vlerësimit në sesione plenare. Projekt raportet më pas u dërgohen qeverive përkatëse për komente, të cilat merren parasysh nga GRETA kur ajo përpilon raportin e saj përfundimtar. Raporti përfundimtar u dërgohet organeve përkatëse, të cilëve u kërkohet të japin komentet e tyre përfundimtare. Raporti i GRETA-s, sëbashku me komentet nga autoritetet, bëhen më pas publike.



KOMITETI I PALËVE NË KONVENTË

— Shtylla e dytë e mekanizmit të monitorimit, Komiteti i Palëve, përbëhet nga përfaqësues kombëtarë të shteteve të cilat e kanë ratifikuar Konventën. Mbi bazën e raporteve të GRETA-s, Komiteti i Palëve mund të miratojë rekomandimet që u drejtohen shteteve individuale lidhur me masat për zbatimin e gjetjeve të GRETA-s.



NGA MONITORIMI NË MBËSHTETJE PËR ZBATIMIN E KONVENTËS

— Vlera e punës monitoruese të kryer nga Konventa e Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore është e trefishtë:

- ▶ ajo vlerëson dhe stimulon përputhshmërinë me detyrimet ambicioze të Konventës;
- ▶ ofron udhëzime, sipas nevojës, për mënyrën sesi të kapërcehen vështirësitë; dhe
- ▶ përbën një forum për bashkëpunimin ndërkombëtar ku mund të ndahet informacioni dhe praktikat e mira duke bërë kështu të mundur stimulimin e masave të përbashkëta për parandalimin dhe trajtimin e problemeve.

— Rezultatet e kësaj pune monitoruese janë të disponueshme në internet dhe janë bërë pikë reference për të gjithë palët e përfshira në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Këshilli i Evropës mbështet gjithashtu qeveritë për zbatimin e Konventës dhe të rekomandimeve që dalin nga procesi i monitorimit.

Për kontakte dhe informacion të mëtejshëm

Sekretariati i Konventës së Këshillit të Evropës kundër Trafikimit
të Qenieve Njerëzore (GRETA dhe Komiteti i Palëve)

Këshilli të Evropës / Council of Europe

F-67075 Strasbourg Cedex

Francë / France

E-mail: Trafficking@coe.int

www.coe.int/trafficking